



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 450/2019**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaqi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur lidhur me apelin e Faton Bislimi nga Gjilani, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 07.11.2019, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave me kusht dhe atyre me postë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 08.11.2019, mori këtë:

## **V E N D I M**

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.450/2019 i datës 08.11.2019, i paraqitur nga Faton Bislimi nga Gjilani, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 07.11.2019, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave me kusht dhe atyre me postë.

## **A r s y e t i m**

Me datë 08.11.2019, kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Faton Bislimi ka paraqitur në PZAP, apelin Anr.450/2019, me të cilën pretendon se pozita e tij, në ranglistën e më të votuarve të LDK-së, ka pësuar rënie nga numri rendor 29 sipas rezultateve preliminare në numër rendor 34 sipas rezultateve përfundimtare, numërimi i votave me kusht dhe atyre me postë pritej se do të lëvizte numrin total të votave të kandidatëve por jo edhe rangimin e tyre për shumë pozita, mirëpo nga lista finale rangimi tek kandidatët ka ndryshuar drastikisht, unë nga pozita 29 tanimë jam “spostuar” në pozitën 34, efektivisht jam eliminuar nga hyrja në Kuvend si deputet, kjo ka ndodhë si pasojë e katapultimit të katër kandidatëve mashkuj para meje (Ismet Beqiri, Shkumbin Gashi, Hatim Baxhaku dhe Xhavit Ukaj), të cilët ishin kogja pas meje me numër të votave sipas rezultateve preliminare. Në fund parashtresës i apelit kërkon që të bëhet rinumërim urgjent i votave me kusht dhe me postë të LDK-së, dhe të dalin në pah manipulimet enorme të bëra në rritjen fallco të votave për kandidatët në fjalë, respektivisht uljen e votave të mia. Po ashtu, kërkoj që abuzuesit dhe keqpërdoruesit e vullnetit të popullit të ndiqen penalisht.

Si dëshmi për pretendimet e tij ka bashkangjitur në apel listen e rezultateve përfundimtare të kandidatëve të subjekteve politik dhe listen e plotë të kandidatëve të LDK-së.

Në përgjigje në apel të datës 09.11.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se në bazë të Rregullës Zgjedhore 06/2013, procedura e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve nuk lejon asnjë Formular të Rezultateve të kaloj (procedohet si i rregullt) nëse nuk përpunohen

votat e subjekteve me votat e kandidatëve, që do të thotë se nëse subjekti nuk ka vota dhe kandidatët kanë vota, atëherë Formulari nuk procedohet i rregullt dhe shkon në Auditim ose subjekti ka vota dhe kandidatët nuk kanë vota, Formulari nuk procedohet i rregullt dhe shkon në Auditim. Auditimi kontrollon të gjitha këto raste dhe në bazë të të gjeturave përgadit raportin dhe QNR në bazë të raportit të Auditimit rekomandon KQZ-në që vendotimet që kanë probleme të kësaj natyre të rinumërohen. Më tutje në përgjigje thekson se pretendimet e palës ankuese nuk qëndrojnë, sepse në rezultatet preliminare ku pala ju është referuar në ankesën e tij, nuk janë përfshirë votat me kusht, votat e votuesve jashtë Kosovës dhe votat e votuesve me nevoja të veçanta, andaj bazuar në nenin 5 paragrafi 7 i Rregullës së PZAP-së nr.02/2015, dhe arsyet e lartëcekura, konsiderojmë se ankesa është e pabazuar dhe si e tillë duhet të refuzohet.

Paneli, pasi që shqyrtoj apelin vlerësoi se:

### **Apeli është i pabazuar**

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatojë se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave me kusht dhe atyre me postë, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë të imagjinuara sepse pritet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Faton Bislimi i subjektit politik LDK, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave me kusht dhe atyre me postë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.450/2019 më datën 08.11.2019

**Kryesuesi i Panelit**

**Rrustem Thaqi**



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.